

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Gentian Kaprata - Një hall, një nder, një vote!
ADRESA	https://www.syri.net/politike/915575/nje-hall-nje-nder-njevote/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 08:53:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 21:00:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fa57cec898a00c133d59c1834a475414007f7a0af5bbc1302265bb397332e5a7
TEKSTI	f087ab40a25a0b5236c754882ec3c51162384ec3d6a752717c30177c59f35a14
PAMJA	73dcc6d5d5fed1b90d483bb6ca7a62f85a079eb9bd246f37cd4bc8b988ce81a4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5063faa052ac44585321b0ea4452b1b24d57ae0fc2408259fe03a6589d606591
E MËPARSHMJA	08d3d64fdcafec4a10d045aa8fd27a2c6c88edc445e7458ec266323b2fce4118
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5063faa052ac44585321b0ea4452b1b24d57ae0fc2408259fe03a6589d606591>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Për ne](#)
- [Redaksia](#)
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)
- [Edicioni i Kosovës](#)
-
- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Op-Ed](#)
 - [Analizë](#)
 - [Blog](#)
- [PLUG](#)
-
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)

toggle menu

 [Ndriçim Kulla Ndriçim Kulla Shqipëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut](#)

 [Irena Begiraj Irena Begiraj Në Shtetin e Ronit!](#)

 [Një hall, një nder, një vote!](#)

-
-
-
-

Një hall, një nder, një vote!

ZMADHO TEKSTIN23:00, 09/09/2026



Nga Gentian Kaprata - Polity & Ideology

Susan Stokes, një nga studiueset më të njohura të klientelizmit politik, ka analizuar mënyrën se si marrëdhënia demokratike ndërmjet qytetarit dhe politikës mund të zëvendësohet dalëngadalë nga një marrëdhënie shkëmbimi personal. Në librin Brokers, Voters, and Clientelism: The Puzzle of Distributive Politics, të shkruar me bashkëautorë, ajo studion pikërisht rolin e ndërmjetësve politikë që njohin qytetarët, nevojat e tyre dhe problemet konkrete mbi të cilat mund të ndërtohet mbështetja politike.

Në Shqipëri nuk kemi pse ta kërkojmë gjatë figurën e brokerit. Ne e kemi. Quhet patronazhist. Ai nuk hyn te qytetari përmes debatit mbi shtetin, taksat, pronën apo ekonominë. Hyn përmes jetës së tij të përditshme. Di kush kërkon punë, kush pret legalizimin, kush ka problem me pensionin, kush ka ngecur në kadastrë dhe kush endet prej muajsh pas një dera të administratës.

Këtu fillon ndryshimi i madh. Politika nuk e pyet më qytetarin 'Çfarë shoqërie dëshiron?'. E pyet 'Çfarë halli ke?'. E para të fton të mendosh, të krahasosh dhe të zgjedhësh ndërmjet ideve. E dyta të lidh me dikë që premtim se mund të të zgjidhë problemin. E para ndërton qytetarin. E dyta ndërton klientin.

Klientelizmi shqiptar ka edhe përmasa të ndryshme. Poshtë është klientelizmi i thërimeve, ku qarkullojnë vende pune, pensione, legalizime, dokumente dhe shërbime administrative. Lart është klientelizmi i banketit, ku përfitimet janë të një shkalle tjetër ekonomike. Por ky shkrim merret me thërrimet. Sepse aty patronazhimi hyn në jetën e qytetarit të zakonshëm dhe, bashkë me hallin, fillon t'i formësojë edhe mënyrën si ai kupton politikën.

Pas trembëdhjetë vitesh patronazhimi, deputetët socialistë dërgohen në territor për të dëgjuar hallat. Qytetari paraqet problemin. Deputeti e merr. Strukturat politike e referojnë. Administrata e ndjek. Në fund mund të vijë edhe zgjidhja. Dhe kur vjen, qytetari largohet me një bindje krejt njerëzore. 'Ma zgjidhën hallin.'

Por aty ku qytetari sheh zgjidhjen, politika ka kryer një shndërrim shumë më të thellë. Pensioni që të takon nuk është dhuratë. Dokumenti që administrata duhet të lëshojë nuk është nder. Legalizimi që duhet të shqyrtohet sipas ligjit nuk ka pse të kërkojë ndërmjetës politik. Qytetari nuk ka nevojë për dikë që t'i hapë derën e shtetit. Ka nevojë që dera të jetë e hapur sepse kështu e kërkon ligji.

Kjo është arsyeja pse ndërmjetësimi politik është kaq i vlefshëm për pushtetin. E drejta nuk ka fytyrë. Favori ka. Qytetari mund të mos kujtojë institucionin që kishte detyrimin t'i jepte shërbimin, por kujton patronazhistin që e dëgjoi, deputetin që telefonoi dhe partinë që 'u interesua'. E drejta bëhet nder. Nderi bëhet mirënjohje. Dhe mirënjohja mund të bëhet votë.

Për vite është ndërtuar pikërisht kjo infrastrukturë ndërmjetësimi. Patronazhisti, strukturat e partisë, Bashkëqeverisja, PasqyrAlbania, 'Prania Besnike' dhe deputetë në territor vendosen në hapësirën që duhet t'i lidhte drejtpërdrejt qytetarin me administratën. Paradoksi është pothuajse absurd. Sa më shumë ndërmjetës politikë duhen që shteti të funksionojë, aq më pak shtet ka. Por sa më shumë ndërmjetësim politik ka, aq më shumë meritë mund të marrë pushteti për funksionimin e tij.

Dëmi, megjithatë, nuk mbetet brenda administratës. Ai kalon te vetë politika. Partitë nuk ekzistojnë për të konkurruar se kush zgjidh më shumë dosje personale. Për këtë ekzistuar administrata publike. Partitë ekzistojnë sepse përfaqësojnë ide të ndryshme për shoqërinë. Ideologjia nuk është dekor i politikës. Është arsyeja pse pluralizmi ka kuptim.

E majta dhe e djathta duhet të dallohen nga përgjigjet që japin për pyetjet themelore. Sa shtet dhe sa individ? Sa centralizim dhe sa vetëqeverisje? Si mbrohet prona? Si tatohet puna dhe kapitali? Si krijohet pasuria dhe si shpërndahet ajo? Gara demokratike duhet të zhvillohet në diagnozën e problemit dhe në arkitekturën e zgjidhjes, jo në numrin e patronazhistëve dhe telefonatave që hapin dyert e administratës.

Klientelizmi zhvendos pikërisht këtë garë. Një program ekonomik kërkon gjykim. Një reformë institucionale kërkon të mendosh për pasojat. Një ideologji kërkon të krahasosh mënyra të ndryshme për të organizuar shoqërinë. Ndërsa pensioni i zhblokuar, vendi i punës apo legalizimi janë të menjëhershme, të prekshme dhe personale. Programi kërkon gjykim. Halli prodhon mirënjohje.

Pas shumë vitesh, kjo logjikë ndryshon edhe mënyrën si matet puna politike. Dëgjon lehtësisht frazën 'Rama punon, deputetët e tij janë në terren. Po opozita çfarë bën?' Por çfarë duhet të bëjë opozita? Të japë pensione? Të legalizojë shtëpi? Të punësojë njerëz? Të telefonojë drejtorë? Nëse ky bëhet standardi i politikës, konkurrenca demokratike është deformuar që në nisje. Partia që kontrollon administratën hyn në zgjedhje me shtetin në xhep.

Kështu ndryshon, pothuajse pa u ndier, edhe pyetja me të cilën qytetari shkon drejt kutisë së votimit. Nuk pyet më se cila parti e kupton më mirë problemin dhe propozon sistemin më të mirë që ai të mos përsëritet. Pyet 'Kush ma zgjidhë hallin?' Në atë çast klientelizmi ka fituar diçka shumë më të madhe se një votë. Ka ndryshuar vetë mënyrën se si politika gjykohet.

Dhe aty vota pushon së qeni zgjedhje ndërmjet ideve, programeve dhe modeleve të ndryshme të shoqërisë. Bëhet faturë mirënjohjeje. Demokracia kërkon pikërisht të kundërtën. Një shtet ku qytetari të mos ketë nevojë për një njeri që njeh një njeri. Një shtet ku, për të marrë atë që i takon, të mos ketë nevojë të njohë as patronazhistin, as deputetin, as Kryeministrin.

Lexo edhe:

-  [Deklaratat përmbyllëse, Prokuroria: Thaçi tentoi ta pengonte procesin gjyqësor duke ndikuar te dëshmitarët](#)
-  [Ditën e gënjeshtreve, 'çuçka' i Ersekës hap SHA-në 'Green Kolonja': Fut në bord Altin Bashën dhe mikën e deputetes së Ramës](#)
-  [Egërsia e stimuluar e 'Kafshës së xhunglës'!](#)

Më të lexuarat

[Politikë](#)

[Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në 'raportim të kufizuar', qeveria fshehu të vërtetën](#)

[Politikë](#)

[Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit](#)

[Politikë](#)

[SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si 'raketë' pyetjeje të Syri Tv për audiopërgjimin](#)

[Politikë](#)

[Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar](#)

[Politikë](#)

[Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija](#)

[Politikë](#)

[Kryengritja e Postribës, Spahia: Ata u ngritën kundër regjimit komunist dhe u bënë shembull për mbarë Shqipërinë](#)

[Politikë](#)

[Roni pasqyra Rama](#)

[Politikë](#)

[80 vite nga kryengritja antikomuniste, Hoti: Mund të shtypësh një kryengritje, por jo një ideal](#)

[Politikë](#)

[Berisha në SHBA, Spahia: Një zhvillim historik jo vetëm për PD por për krejt Shqipërinë – Rama drejtues i një rrjeti kriminal...](#)

[Politikë](#)

[Paloka: SPAK-u është kthyer në zjarrfikës të gjitha aferave korruptive të Edi Ramës](#)

TË NGJASHME

[Politikë](#)

[Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313: Kufizimi i takimeve të Ilir Metës, shqetësim serioz për respektimin e të drejtave](#)

[Politikë](#)

['Rama të japë llogari për kompaninë 'Kayo', Hitaj: SPAK të sqarojë lidhjet Balluku-Tare](#)

[Politikë](#)

[Bomba e përgjimeve nga Arben Ahmetaj, Qyno: SPAK dje hodhi një shashkë me vilën e sekuestruar të Ballukut](#)

[Politikë](#)

['Tenderat e Mbrojtjes, 'miniera e radhës', Peka: Rama po përgatit skemën e re të vjedhjes së milionave](#)

[Politikë](#)

[80 mln € më shumë/ Nafta 'rrjep' shqiptarët, mbush arkën e shtetit](#)

[Politikë](#)

[Virusi i Nilit, Dasho: Testimi i kontakteve nuk mjafton, mund të ketë të infektuar të tjerë](#)

[Politikë](#)

[Vazhdon bojkoti në gjykatat shqiptare/ Sot mblidhen gjyqtarët për çështjen e pagave](#)

- Lajme
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)

- [Jjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Arkiva](#)

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

[Denonco](#)

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.